

Qeveria në largim vazhdon të rrit shpenzimet e planifikuara, gjegjësisht shpenzimet për vitin 2017, të cilat në Buxhetin e planifikuar para zgjedhjeve do të kenë shumë rekorde prej 3,35 miliardë euro. Duke marrë parasysh që janë planifikuar të ardhura më të vogla me shumë prej 3,05 miliardë euro, kjo nënkupton që deficitin buxhetor do të vazhdon të rritet, kurse mangësitë do të mbulojnë me huamarrje të reja në tregun e vendit dhe të jashtëm.

Deficiti buxhetor është projektuar në 300 milionë euro, gjegjësisht i njëjti paraqet 3% nga BPB, krahasuar me 0,55% nga BPB në vitin 2006. Shuma e deficitit për vitin 2017 është gati se 11 herë më e madhe në shumë absolute nga deficitin buxhetor në vitin 2006 kur ai ka qenë 28 milionë euro. Akoma më shumë shqetëson fakti që në fund të vitit deficitin i realizuar është mjaft më i madh se sa ai i projektuar fillimisht, kështu që praktika e viteve të fundit të kësaj Qeverie tregoi që në vitin 2014, për shembull, dallimi mes deficitit të realizuar dhe atij të projektuar është 63 milionë euro.


Nga struktura e shpenzimeve mund të vërehet që edhe në vitin 2017 shpenzimet për shërbimet e kontratave, gjegjësisht mjetet që pushteti i përdor për pagesë të konsulentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm janë më të mëdha për 55 milionë euro në krahasim me shpenzimet kapitale. Duke marrë parasysh që shpenzimet për shërbimet e kontratave dhe pagesa e rrogave për administratën arrin shumën prej 1 miliardë euro, që është 1/3 e tërës buxhetit, do të thotë që kjo Qeveri nuk ndërton! Kjo Qeveri e shpenzon buxhetin shtetëror në mënyrë joproduktive. Raporti i shpenzimeve kapitale me këto shpenzime është 1:2.

Përveç pretendimit që kjo Qeveri nuk ndërton, këtë e tregon edhe rebalanci i Buxhetit për vitin 2016 në të cilin 407 milionë euro të planifikuara për investime kapitale janë zvogëluar për 45 milionë euro, përkundër shpenzimeve të rritura për shërbime të kontratave dhe pagesa të rrogave për 11 milionë euro.

(në miliardë euro)


Buxheti i RM

për 2006 - 2016 - 2017




(në miliardë euro)

Të ardhura dhe shpenzimeve të projektuar në buxhetet për vitet 2006, 2016 dhe 2017



Deficit buxhetor


i projektuar



(në milionë euro)

Struktura e shpenzimeve 2017

(shërbime të kontratave / rroga / shpenzime kapitale)



shërbime të kontratave ● rroga ● shpenzime kapitale ●